

PROCESI I KOMPENSIMIT

KOMPENSIMI i depozitës së siguruar është vlera monetare, deri në nivelin maksimal ligjor 2.000.000 lekë, që i njihet ose i paguhet depozituesit në rast të likuidimit të detyruar të shkk-së.

Shuma në lekë që përfiton çdo depozitues në rast kompensimi, llogaritet: Shuma totale e depozitave të tij, përfshirë interesin deri në ditën e vënies së shkk-së në likuidim, për secilën prej depozitave, duke zbritur shumën e detyrimeve të papaguara në kohë të depozituesit ndaj shkk-së. Depozitat në valutë konvertohen në lekë, sipas kursit të këmbimit, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e vendosjes së shkk-së në likuidim të detyruar.

HAPI 1

Nisin Procedurat e kompensimit

Procedurat e kompensimit fillojnë menjëherë, në momentin kur ASD njoftohet me shkrim nga Banka e Shqipërisë për vendosjen e shkk-së në likuidim të detyruar. Depozituesit nuk kanë nevojë të ndërmarrin asnjë veprim deri në njoftimin zyrtar të ASD-së.

HAPI 2

Përgatitja e ASD-së për kompensim

ASD merr të dhënat për depozitat dhe depozituesit nga shkk-ja e vendosur në likuidim. Këto të dhëna përpunohen për të gjeneruar listën përfundimtare të depozituesve me shumën përkatëse për kompensim. ASD dërgon listën përfundimtare së bashku me fondet tek banka agjente në të cilën do të kryhen pagesat.

Ndërkohë që bëhen përgatitjet Agjencia njofton depozituesit në lidhje me fillimin e procesit të kompensimit, bankën agjente që do të kryejë kompensimin dhe i përgjigjet të gjithë pyetjeve të depozituesve nëpërmjet mjeteve të saj të komunikimit.

HAPI 3

Kryerja e pagesës

Për të përfituar shumën e kompensimit, depozituesit duhet të paraqesin në sportelet e bankës agjente:

Dokumentin e identifikimit dhe

Kopje të Kontratës së Depozitës ose çdo dokument tjetër që vërteton pretendimin mbi kompensimin e depozitës.

Kompensimi kryhet përmes:

- pagesës së shumës në lekë personit në ambientet e bankës agjente;
- transfertës së shumës që përfitohet nga depozituesi në një bankë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;
- ose mënyrave të tjera të ofruara nga ASD sipas rasteve.

HAPI 4

Mbyllja e procesit

Procesi i kompensimit përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të tij. Agjencia njofton depozituesit për mbylljen e procesit të kompensimit si dhe trajton rastet e veçanta dhe pretendimet. Çdo depozitues, që nuk është paraqitur për t'u kompensuar brenda afatit ligjor të kompensimit, i ruhet e drejta për kompensim, brenda 10 vjetëve.

DEPOZITA TË SIGURTA KOMPENSIM I GARANTUAR DERI NË 2.000.000 LEKË



Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) që prej vitit 2002 është institucioni përgjegjës për administrimin e skemës së sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë. ASD siguron depozitat tuaja në çdo shoqëri kursim-krediti (shkk) dhe kompenson ato deri në nivelin maksimal 2.000.000 lekë, në rast se shkk-ja nuk është më në gjendje të paguajë depozitat tuaja.

Vetëm shkk-të anëtare të skemës së sigurimit të depozitave lejohen të ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë. Anëtarësimi i tyre në skemë është i detyrueshëm.

PËRFITUES nga skema e sigurimit të depozitave është çdo depozitues anëtar i shkk-së: individ, tregtar dhe shoqëri tregtare, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj, i cili ka depozitë në një shkk, në lekë ose në monedhë të huaj, sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Sigurimi i depozitave në shkk fillon nga data 1 Janar 2017.

Nëse keni pyetje kontaktoni me shkk-në tuaj ose me ASD

Rruga e Elbasanit, nr.317 Tiranë

T: +355 42 362 989, +355 42 347 298

F: +355 42 362 984

@: info@asd.gov.al/ www.asd.gov.al

f Agjencia e Sigurimit të Depozitave



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

DEPOZITAT E SIGURUARA

Agjencia siguron dhe kompenson **ÇDO DEPOZITUES, NË ÇDO SHKK** deri në nivelin maksimal ligjor 2.000.000 lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës.

DEPOZITAT E SIGURUARA NGA ASD JANË:

- ✓ Depozitat me afat
- ✓ Depozitat pa afat

DEPOZITUESIT NUK KANË ASNJË KOSTO për sigurimin e depozitave të tyre. Shkk-të kanë detyrimin ligjor të paguajnë për to.



DEPOZITAT E PËRJASHTUARA NGA SIGURIMI

- × depozitat e shkk-së, në emër dhe për llogari të vet, si dhe çdo subjekt tjetër financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- × depozitat e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë së kursim-kreditit, sipas përcaktimeve në ligjin për shoqëritë e kursim-kreditit, përveç asamblesë së përgjithshme.
- × depozitat e çdo personi që zotëron 5 për qind ose më shumë në kapitalin e subjektit anëtar ose të aksioneve me të drejtë vote në këtë subjekt;
- × depozitat e prejardhura nga veprimtari të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë deklaruar të paligjshme me vendim gjykate të formës së prerë;
- × depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, vendase ose të huaja;
- × depozitat e subjekteve të sipërmarrjes ose investimeve kolektive, vendase ose të huaja;
- × depozitat e fondeve të pensionit ose sigurimit pensional, vendase ose të huaja;
- × tituj të emtuar nga subjekte financiare dhe çdolloj detyrimi tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit;
- × depozitat e njësisve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe çdo enti publik të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj
- × depozitat të paemërtuara dhe/ose titulli i të cilave nuk përcaktohet qartë;
- × depozitat e vendosura në subjektin anëtar të skemës së sigurimit të depozitave gjatë dhe pas ditës së ngjarjes së sigurimit në këtë subjekt;
- × depozitat e personave juridikë, përveç atyre të përcaktuara në pikën 17, të nenit 3, të ligjit



Ju keni disa depozita në të njëjtën shkk, në lekë ose në çdo monedhë tjetër.

Depozitat tuaja janë të siguruara si në lekë ashtu edhe në monedhë të huaj. Të gjithë depozitat, në lekë apo në monedhë të huaj (të cilat konvertohen në lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë), mbliidhen dhe kompensonen deri në 2.000.000 lekë.

Ju keni një depozitë të përbashkët.

Secili depozitues zotëron pjesë të barabarta në depozitën e përbashkët, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kontratën e depozitës. Kompensimi që përfiton secili bashkëpronar, deri në 2.000.000 lekë, përfshin shumat në depozitat personale që mund të ketë, si edhe pjesën që i takon nga depozita e përbashkët.

keni një depozitë si individ dhe një depozitë të biznesit tuaj, në të njëjtën shkk.

Ju do të kompensonen deri në 2.000.000 lekë për secilën prej tyre.

NË ÇDO RAST, SHUMA MBI 2.000.000 LEKË, NUK KOMPENSOHET NGA AGJENCIA.

IDENTIFIKOHU!

Identifikimi korrekt i secilit depozitues është element kyç për të mundësuar kompensim të shpejtë dhe të saktë. Çdo neglizhencë lidhur me të dhënat e depozituesve do të vështirësojë e vonojë procesin. Të dhënat minimale që çdo depozitues duhet të regjistrojë në shkk në mënyrë që të mos ketë asnjë pengesë për të përfituar atë që i takon, janë:

INDIVIDË

- emri, mbiemri
- numri personal
- numri i dokumentit të identifikimit
- atësia
- datëlindja
- adresa
- numri i telefonit

TREGTAR OSE SHOQËRI TREGTARE

- numri unik i identifikimit të subjektit
- emërtimi
- data e regjistrimit
- forma ligjore

Ju lutemi të:

- ✓ depozitoni një kopje të dokumentit të identifikimit në shkk;
- ✓ njoftoni menjëherë shkk-në për çdo ndryshim të të dhënave të mësipërme;
- ✓ depozitoni nënshkrimin apo firmën dhe nënshkruani çdo dokument që tregon apo autorizon lëvizjet nga llogaria depozitë e juaj;
- ✓ njoftoni Agjencinë për çdo parregullsi që vëreni në drejtim të mbajtjes së të dhënave tuaja të mësipërme dhe të procesit të identifikimit tuaj.